

Henrik Ligori




PROKUROR PRANË PROKURORISË
PËR KRIME TË RËNDA TIRANË

Deklaratat e analizuara:

15 Deklarata të analizuara

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2004 deri
Periodik/Vjetor 2017)

Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklarimit deri në vitin 2017




Pasuria bruto është rritur 7.7 herë.

+ 4,409,871 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë.


Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë


Likuiditete
në Bankë




Likuiditete
në Cash



Pasuritë e
Luajtshme



Pasuritë e
Paluajtshme



Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

Të Ardhurat 2004-2017	Shuma në Lekë	Raporti në %
Të ardhura nga paga dhe shpërblime nga funksioni	24,542,284	35.7%
Të ardhura nga pagat e bashkëshortes	14,936,738	21.7%
Të ardhura nga aktiviteti privat i bashkëshortes	22,439,325	32.6%
Të ardhura nga mësimdhënia	3,498,180	5.1%
Të ardhura nga qeraja	906,000	1.3%
Dhurata në Cash	200,000	0.3%
Të ardhura të tjera	2,249,700	3.3%
Total	68,772,227	100%



Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 14 vite rezultoi:

3 deklarata Me Probleme
11 deklarata Pa Probleme

Subjekti Henrik Ligori rezulton me burime financiare të deklaruara të pamjaftueshme për të mbuluar shtesën e aseteve gjatë viteve 2009, 2010 dhe 2016, pa llogaritur në këtë analizë shpenzimet vjetore për konsum familjar.

Në vitin 2009, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit deklaroi blerjen e një apartamenti banimi me vlerë 250,000 euro, me burim një kredi bankare prej 150,000 eurosh dhe kursimet familjare ndër vite. Gjithashtu deklaroi blerjen e një garazhi me vlerë 28,000 euro, për të cilën ka paguar vetëm koston e parë prej 10,000 eurosh. Në analizë u zbritën kursimet e deklaruara të viteve të mëparshme dhe të ardhurat vjetore, por sërisht rezultoi një diferencë prej 6,752,184 lekësh.

Në vitin 2010, deklarohet shlyerja e kredisë prej 96,594 euro që shërbeu për blerjen e apartamentit në vitin 2009, me burime të deklaruara pakësimin e kursimeve cash në vlerat 52,000 euro dhe 37,000 euro. Por subjekti dhe bashkëshortja e tij i kishin deklaruar të pakësuara kursimet ndër vite me blerjen e apartamentit, duke rezultuar me burime të pamjaftueshme për vitin 2010 në vlerën e 11,108,019 lekë.

Gjithashtu në vitin 2016, subjekti deklaroi shtesë asetesh dhe likuiditetesh me vlerë 8,481,443 lekë dhe pavarësisht të ardhurave të konsiderueshme për vitin, rezultoi me diferencë negative prej 1,164,895 lekësh.